



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 2 paragrafi 2.1 ndërlidhur me nenet 4, 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr.04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional, Vendimit nr.2-3726 për Institucionet e Arsimit dhe aftësimin Profesional të nxjerrë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë-MASHT më datë 28.08.2019, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 19 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas propozimit të Drejtorisë së Arsimit të datës 28 qershor 2022, si dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa nga mbledhja e mbajtur më 28.06.2022, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2022, mori këtë,

### VENDIM

**Për ndryshimin e emërimit të dy shkollave të mesme profesionale SHMLT “Fan S. Noli” dhe SHMLE “Isa Boletini” nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale, në Institucione të Arsimit dhe Aftësimin Profesional – IAAP**

#### Neni 1

Me këtë vendim, SHMLT “Fan S. Noli” dhe SHMLE “Isa Boletini” në Podujevë, nga Shkolla të Mesme të Larta Profesionale, emërtohen Institucione të Arsimit dhe Aftësimin Profesional – IAAP.

#### Neni 2

Ndryshimi i emërtimeve të dy institucioneve arsimore sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të rregullimit, strukturimit, organizmit dhe menaxhimit të institucioneve përkatëse të cilat ofrojnë arsim dhe aftësim profesional duke marrë për bazë Ligjit nr.04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional, Vendimin nr.2-3726 datë 28.08.2019 për Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional të MASHT si dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit e Komunës së Podujevës.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot. 04-610/01-0053360/22  
Podujevë, Datë; 30.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha